VENDIM
Nr. 44, datë 11.9.2012

PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE "PËR KRIJIMIN E FONDIT TË INOVACIONIT"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:
- Z. Edmond Haxhinasto Kryetar;
- Z. Zef Preçi Nënkryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi Anëtare;
- Z. Dritan Hylli Anëtar.

Në mbledhjen e tij të datës / /2012, shqyrtoi planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për krijimin e fondit të inovacionit" të paraqitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të regjistruar pranë saj në regjistrin me nr. A1/N/13/2012.

Objektivi/vat: Plani për dhënien e ndihmës ka si objektiv rritjen e inovacionit nëpër ndërmarrjeje, si një mjet i përmirësimit të konkurrueshmërisë së tyre.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës:

VËREN SE,

1. Fondi i Inovacionit u jep ndihmë në formë subvencioni të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë. Në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar nga aplikanti/tët, skema mbulon nga 30% deri 50% të kostove të pranueshme dhe të miratuara, brenda kufirit të lartpërmendur.

2. Skema ka një kohëzgjatje zbatimi 4 (katër) vjet, për periudhën 2011-2014.

3. Kostot e pranueshme, që mund të bashkëfinncohen, përfshijnë kostot për:

a) auditimin e inovacionit dhe të teknologjisë, që synon t'u mundësojë ndërmarrjeve aplikante vlerësimin e pozicioneve të tyre aktuale dhe mundësitë për profilin e tyre të inovacionit dhe/ose pozicionimit teknologjik, sipas një strukture konkurruese zhvilimi;

b) ndërkombëtarizimin e teknologjisë, e cila synon t'u mundësojë ndërmarrjeve aplikante të identifikojnë dhe të inspektojnë teknologjinë që kërkojnë të përshtatin.

4. Skema ka karakter përzgjedhës, sepse jo të gjitha ndërmarrjet janë të afta për të aplikuar dhe më pas për plotësuar të gjitha kriteret e përfitimit të përcaktuara në rregulloren e funksionimit të fondit të inovacionit.

5. Në lidhje me efektin në tregti skema ka ndikim në veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve në një treg të caktuar, sepse ka edhe ndërmarrje të tjera që veprojnë në këtë treg.

6. Si bazë ligjore për dhënien e ndihmës është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 667, datë 28.9.2011 "Për krijimin e Fondit të Inovacionit".

7. Dhënësi i ndihmës është Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

8. Skema konsiderohet si ndihmë "*de minimis*", në bazë të nenit 8 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, "ndihma *de minimis* është e lejueshme nëse ajo, pavarësisht formës ose qëllimit për të cilin jepet, nuk kalon vlerën prej 100 000 eurosh, për një periudhë financiare prej tre vjetësh dhe në të njëjtën kohë, nuk jepet për veprimtaritë e eksportit, nuk kushtëzohet me përdorimin e produkteve vendase kundrejt produkteve të importuara dhe përfituesi nuk është një ndërmarrje në vështirësi".

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 8, nenit 17 shkronja "ç" të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit të Inovacionit”.

2. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve duhet të verifikojë të gjitha format e ndihmës që ndërmarrja përfituese e fondit të inovacionit mund të ketë marrë ose merr nëpërmjet programeve të tjera në mënyrë që vlera e akumuluar e të gjitha formave të ndihmës në asnjë rast të mos kalojë vlerën prej 100 000 eurosh, për një periudhë financiare prej tre vjetësh dhe me kusht që ndihma të mos jepet për veprimtaritë e eksportit dhe ndërmarrjet në vështirësi.

3. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Edmond Haxhinasto